




Lajmet e Fundit:

DVP Durrës – Procedohet penalisht 1 shtetase, arrestohen në flagrancë 2 të tjerë



Lajmet

20/11/2021

Krujë – Theu masën e sigurisë “Arrest në shtëpi” dhe qëllloi me armë zjarri në ajër, në fshatin Arrameras, arrestohet në flagrancë nga Policia

21-vjeçari, me precedent penal në fushën e vjedhjes së pronës dhe armëmbajtjes pa leje.

Shërbimet e Komisarariatit të Policisë Krujë, pas njoftimit se në fshatin Arrameras, kishte të shtëna me armë zjarri, menjëherë kanë organizuar punën dhe në bashkëpunim me forcën operacionale të DVP Durrës kanë shkua në drejtim të vendit ku ishte dhënë njoftimi.

Si rezultat i veprimeve të shpejta profesionale dhe informacioneve të marra në rrugë operative u bë i mundur identifikimi, kapja dhe arrestimi në flagrancë i shtetasit L. B., 21 vjeç, banues në fshatin Borizanë, i dënuar më parë vjedhje.

Ky shtetas kishte thyer masën e sigurisë “Arrest në shtëpi”, kishte shkua në fshatin Arrameras dhe në orët e mbrëmjes ka qëlluar me armë zjarri pistoletë në ajër, në afërsi të banesave.

21-vjeçari, sapo ka parë shërbimet e Policisë ka fshehur armën e zjarrit dhe është largua, por është kapur disa minuta më vonë.

Vijon puna për gjetjen e armës së zjarrit pistoletë me të cilin 21-vjeçari ka qëlluar në ajër.

Materialet i kaluan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Krujë, për veprime të mëtejshme, për veprat penale “Armëmbajtja pa leje”, “Prishja e rendit dhe e qetësisë publike” dhe “Largimi i të burgosurit nga vendi i qëndrimit”.

Share

Share

Share

Share

Email

◀ DVP Lezhë/Sqarim

“Dita Botërore e Përkujtimit të Viktimave të Trafikut Rrugor”/ Drejtori i Policisë Rrugore, Altin Qato, së bashku me Drejtorin e DPSHTRR, Bledi Gonxhe, prononcim për median ▶

Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital



GET IT ON

Google Play



Download on the App Store

Arkiva

Select Month



Linqe

- > [Arkiva](#)
- > [Akademia e Sigurisë](#)
- > [Ministria e Brendshme](#)
- > [Shërbimi Për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat](#)
- > [Interpol](#)
- > [Europol](#)
- > [Misioni PAMECA V](#)
- > [SCPA](#)
- > [Projekti Trivalent](#)